



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

---

Nr. 252/7 Prot.

Tiranë, më 29.06.2016

**V E N D I M**

**Nr 68, Datë 29.06.2016**

**PËR**

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË  
SUBJEKTIN “FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT” MBI “ZBATIMIN E  
LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË VEPRIMTARISË  
EKONOMIKO-FINANCIARE” PËR PROJEKTIN “REHABILITIMI I  
RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë, dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në subjektin “Fondi Shqiptar i Zhvillimit” Tiranë, për projektin “Rehabilitimi i rrugëve dytësore dhe lokale” për periudhën 01.01.2014 deri 31.03.2016.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm i KLSH, dërguar me shkresën nr. 525/9, datë 10.09.2014, rezultoi se janë zbatuar pjesërisht rekomandimet e dhëna nga KLSH:

Nga 8 masa organizative, janë realizuar 5 masa plotësisht, 1 masë është në proces zbatimi dhe 2 nuk janë zbatuar. Janë realizuar plotësisht 4 masa për shpërblim dëmi si dhe rezultoi se është në proces zbatimi 1 masë administrative.

**Për këtë rekomandojmë:**

*FSHZH, të marrë masat për zbatimin e plotë të rekomandimeve të porealizuara nga auditimi i mëparshëm i KLSH, me qëllim realizimin e dy propozimeve organizative dhe të një mase administrative.*

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i marrëveshjeve të financimit dhe konkretisht referuar korrespondencës së Ministrisë së Ekonomisë me nr. 17658/1; nr. 17658/2; nr. 17658/3, dërguar në KfW më datë 19.12.2013 me objekt shtyrje të afatit të disbursimeve për projektin “Fondi i Investimeve Sociale IV”, financuar nga KfE, konstatohet se: KfW ka dhënë miratimin e saj për shtyrje të afatit të disbursimeve deri në datën 30.06.2017. Afati i disbursimeve për fondet IPA, përcaktohet nga data e fundit për ekzekutimin e planit të veprimit të punimeve siç përcaktohet në marrëveshjet me BE-në dhe për këtë arsye nuk mund të shtyhet përtej datës 08.04.2016. KfW në përgjigjen e saj zyrtare i ka tërhequr vëmendjen Ministrisë së Ekonomisë dhe FSHZH-së, se pavarësisht shqetësimeve të tyre, për ecurinë e ngadaltë të implementimit të projektit, kjo vonesë në implementimin e tij nuk mund t’i atribuohet KfW-së, dhe për këtë arsye, nuk ofrohet më shtyrje e afatit të disbursimeve mbas kësaj date. Realizimi i huasë deri në momentin e auditimit është në masën 64%. Për mungesë menaxhimi me efektivitet të këtij projekti dhe vonesa në implementimin e tij, ngarkohet me përgjegjësi FSHZH

**Për këtë rekomandojmë:**

*Nga FSHZH të merren masa, për të përmirësuar ecurinë e disbursimeve për kreditë e KfE-së, bazuar në marrëveshjen e financimit për periudhën e shtyrjes së afatit të përfundimit të disbursimeve deri në vitin 2017.*

*Menjëherë dhe në vazhdim*

**3. Gjetje nga auditimi:** Në një rast dhe konkretisht për nën projektin “Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Qesarakë” vërehet se është pranuar dhe paguar vlera e situacionit të paraqitur nga ana e supervizionit, në një kohë kur ky situacion përmbante vlera për punime të kryera jashtë periudhës së përcaktuar në kontratë, për

të cilat ende nuk ishte marrë miratimi i donatorit për shtyrjen e kësaj periudhe. Miratimi për këtë urdhër ndryshimi nga Donatori është bërë një muaj pas pagesës së situacionit.

**Për këtë rekomandojmë:**

*Spektori i Financës të marrë masa për kryerjen e pagesave të situacioneve vetëm për punime të tjera brenda afatit dhe përcaktimeve të kontratës, si dhe me disponimin e të gjithë dokumentacionit justifikues dhe miratues të nevojshëm, që justifikon dhe vërteton kryerjen e punimeve të situacionuara.*

*Menjëherë dhe në vazhdim*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje për shpenzimet operacionale, rezultoi se për zërin dieta, financiar nga kredia e IDB dhe Qeveria Shqiptare, mungojnë urdhër pagesat nga titullari dhe urdhër shërbimet për dërgimin e punonjësve jashtë qendrës së punës apo programet e punës. Këto pagesa janë kryer bazuar vetëm në faturat e hoteleve të paraqitura dhe në një format “Shërbimi jashtë qendrës së punës” ku përcaktohen vetëm afatet e qëndrimit jashtë vendit të cilat mbajnë vetëm firmën e drejtuesve të departamenteve. Po kështu, gjatë shqyrtimit të këtyre transaksioneve, u konstatua se i gjithë dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk përmban numrin, datën dhe vulën e protokollit në kundërshtim me nenin 12 dhe 13 të “Normave tekniko-profesionale për Arkivat.

**Për këtë rekomandojmë:**

*Në të ardhmen Spektori i Financës të mbajë një dokumentacion të plotë mbi transaksionet që realizon, dhe çdo pagesë të jetë e shoqëruar me dokumentacionin justifikues përkatës, (urdhër shërbim, urdhër shpenzim, program pune, planifikime paraprake, etj) i cili të përmbajë të dhënat e nevojshme dhe arsyet e nevojës për secilin shpenzim, si dhe të merren masa që i gjithë dokumentacioni që qarkullon brenda apo jashtë njësisë, të ketë numrin, datën dhe vulën e protokollit.*

*Menjëherë dhe në vazhdim*

**5. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin “**Rikonstruksion i rrugës Qeparo-Kudhës-Kuç, segmenti Qafe Shper-Kudhës, Qarku i Vlorës**” njoftimi për zhvillimin e tenderit në faqen ëeb të BERZH mban datën 23.09.2014. Në këtë njoftim, ndër të tjera bazuar në Komponentin 1 të marrëveshjes “Punimet civile për segmente në prioritet për rrugë dytësore dhe lokale” përcaktohet se: “Ndërhyrjet sipas këtij komponenti përfshijnë rehabilitimin ose rikonstruksionin. Për rikonstruksionin, e gjithë shtresa do të rindërtohet me shtresa të reja asfalti me nënshtresat e domosdoshme. Për rehabilitimin, punimet do të konsistojnë në shtresë të re bazë me shtresë të re asfalti, ku është e domosdoshme, si dhe infrastrukturë të sigurisë rrugore të përfshira”. Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me marrëveshjen e financimit, duke prokuruar rikonstruksionin e një rruge pa shtresë asfalti.

- Në dokumentet e tenderit pika 22. 2. b, është vendosur kriteri: “*Mesatarja vjetore e volumit për punimet e gërmimit, për vitet 2009 deri 2013 duhet të jetë 656,000 m<sup>3</sup>*”. Rezulton se për një periudhë 5 vjeçare operatorët ekonomikë duhet të kenë realizuar mesatarisht 3,280,000 m<sup>3</sup> gërmime. Shprehur në vlerë, indirekt është kërkuar të realizohen punime të ngjashme rreth 7 milionë Euro, ndërkohë që në kërkesën përkatëse për punime të ngjashme është kërkuar vlera 3.9 milionë Euro. Kërkesa për realizimin e punimeve të ngjashme në këtë vlerë është shumë e madhe dhe vetëm një numër i vogël operatorësh ekonomikë mund ta plotësojnë. Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzuesin “Rregullat dhe politikat për projekte të financuara nga BERZH”, Pika 3.1 ku përcaktohet: “*Dokumentet e tenderit janë baza për informimin e ofertuesve me kërkesat specifike për shërbime mallra apo punime, kështu që duhet të japin të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të lejuar ofertuesit të paraqesin oferta të përgjegjshme. Dokumentet e tenderit duhet të përgatiten në mënyrë që të inkurajojnë garë ndërkombëtare. Ato duhet të definojnë qartë fushën e punimeve, furnizimeve apo shërbimeve, të drejtat dhe detyrimet e blerësit apo furnizuesit, kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë që një ofertues të deklarohet i përgjegjshëm dhe nuk duhet të vendosen kritere diskriminimi për zgjedhjen e ofertuesit fitues. Detajet dhe kompleksiteti duhet të variojnë në përputhje me madhësinë dhe natyrën e kontratës...*”. Si pasojë e vendosjes së këtij kriteri, është skualifikuar nga gara një operator ekonomik, si dhe është limituar mundësia për pjesëmarrje të operatorëve të tjerë të mundshëm në këtë procedurë prokurimi.

- Rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “.....” Sh.p.k, është kualifikuar edhe pse në dokumentet e tenderit të paraqitura ka patur mangësi (është paraqitur vetëdeklarim për xhiron vjetore, të pa konfirmuar nga organet tatimore). Ky fakt duhet të trajtohej në raportin e vlerësimit dhe duhet të kërkohej shpjegime. Theksojmë se për këtë rast, nuk ka një trajtim të barabartë për operatorët ekonomikë, sepse për operatorin ekonomik “.....” Sh.p.k, ky kriter është konsideruar kualifikues.

***Për këtë rekomandojmë:***

*FSHZH të marrë masat e duhura për parashikimin e fondeve për realizimin e plotë të investimit të segmentit rrugor “Rikonstruksion i rrugës Qeparo-Kudhës-Kuç, segmenti Qafe Shper-Kudhës, Qarku i Vlorës”, me synim minimizimin e kostove që vijnë si pasojë e ndërtimit, pa realizuar shtresat asfaltme, sipas parashikimeve në marrëveshjet përkatëse të kredisë.*

***Menjëherë***

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i Rrugës Shishtavec Loti 3” konstatojmë se, Operatorit Ekonomik “.....” është tërhequr nga gara, veprim i cili është shoqëruar me konfiskimin e garancisë së ofertës.

Garancia e ofertës është vendosur me vlerë 6.8 milionë lekë, ose 1.5 % e çmimit të kontratës. Vendosja e garancisë në nivelin 1.5 % dhe jo 2 % siç aplikohet në këto raste, ka bërë që institucioni të jetë më pak i mbrojtur nga tërheqja e mundshme e operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me udhëzuesin e procedurave të prokurimit të donatorit Pika 4.14.

FSHZH si pasojë e tërheqjes së operatorit ekonomik “.....” nga oferta, **ka pësuar humbje financiare me vlerë 2,277,000 lekë**, vlerë e cila përfaqëson fitimin e munguar nga mos përcaktimi i sigurimit të ofertës në masën 2 %. Po ashtu vendosja e një vlere të ulët të sigurimit të ofertës ka bërë që operatori të tërhiqet më lehtësisht nga gara, veprim i cili ka bërë që FSHZH të detyrohet të nënshkruajë kontratën më ofertën më të ulët ndjekëse më Operatorin “.....” sh.p.k me vlerë 344,927,800 lekë, duke shkaktuar realizim të punimeve me vlerë më të lartë në shumën 52,133,620 lekë .

#### **Për këtë rekomandojmë:**

- FSHZH, për projekte në proces dhe që do financohen në të ardhmen, në bashkëpunim me donatorët, të marrë masa për vendosjen e kriterit për mos nënshkrimin e kontratës me operatorin e dytë të renditur (apo operatorë të tjerë), nëse diferenca e ofertave është më e madhe se vlera e garancisë së ofertës, në mënyrë që të minimizohen mundësitë për abuzime nga ana e operatorëve ekonomikë dhe të rriten përfitimet nga proceset e prokurimit.

- Në prokurimet që do realizohen nga FSHZH në të ardhmen, të merren masa për vendosjen e vlerës së garancisë në masën 2 %, në mënyrë që të ketë mbrojtje nga tërheqjet e mundshme të operatorëve ekonomikë nga gara.

#### **Menjëherë dhe në vazhdim**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit “**WL Rec 142. “Rikonstruksioni i rrugës nr. 1, Lagje nr. 4, Sarandë”**”, afati i vendosur për realizimin e objektit sipas kësaj procedure 6 muaj. Referuar përmasave dhe volumit të punimeve, vendosja e këtij afati ka sjellë pasoja në lidhje me periudhën e vënies në eficiencë të investimit, si dhe kostos që lidhet me shpenzimet e përgjithshme të kontratës.

-Nga çmimi i kontratës me vlerë 77,058,333 lekë është ngurtësuar vlera 13.3 milionë lekë ose 17.2 % e vlerës së preventivit, vlerë e cila nuk është argumentuar me analizë çmimesh, duke mos u dhënë mundësinë operatorëve ekonomikë të ofertojnë dhe të paraqesin çmimet e tyre, veprim në kundërshtim me dokumentet e tenderit.

Referuar pikës 1.9 të preventivit “Menaxhimi i trafikut dhe siguria në rrugë” është parashikuar vlera 4.8 milionë lekë, vlerë e cila është likuiduar plotësisht. Në dokumentet e tenderit “Metodat standarde të matjes dhe përshtetja e zërave” Pika 1. 9, përcaktohet: “Përgjatë ekzekutimit të punimeve merren masa për sigurimin e publikut dhe të personave që kanë lidhje direkt ose indirekt me punën. Përbushja e sigurisë sipas legjislacionit të shëndetit përfshirë dhe pa u limituar ligjet edhe

*rregulloret e aplikuara në Republikën e Shqipërisë, ose autoritetet. Kontraktori do të jetë përgjegjës për sigurinë e kalimtarëve në territorin e punimeve...”. Nisur nga gjatësia e kësaj rruge e cila nuk është e konsiderueshme, vendosja e vlerës së mësipërme nuk është e argumentuar, madje shumë më e madhe se në disa kontrata të zbatuara sipas këtij projekti si psh në segmentin rrugorë në Bashkinë Lezhë për të njëjtin zë punimi është vendosur vlera 600,000 lekë, për kohëzgjatje të njëjtë të përfundimit të punimeve.*

Vendosja e çmimeve fikse për të cilat nuk është kërkuar që nga operatorët të paraqitet ofertë financiare, është në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të Bankës Botërore.

#### **Për këtë rekomandojmë:**

*FSHZH të marrë masa që për procedurat që do zhvillohen në të ardhmen, të argumentojë dhe përcaktojë vlerat për shpenzime të përgjithshme në një masë të pranueshme sa më ekonomike, pa cënuar menaxhimin e procesit të ndërtimit. Në dokumentet e tenderit duhet që zërat e shpenzimeve apo shërbimeve që parashikohen në shpenzimet e përgjithshme të vendosen pa vlerën përkatëse, në mënyrë që operatorët ekonomikë të përllogarisin në mënyrë të pavarur vlerat e shpenzimeve.*

#### ***Menjëherë dhe në vazhdim***

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të procedurave të tenderit “**Rikonstruksioni i rrugës Tamarë-Vermosh Loti I**” nga FSHZH është kërkuar që operatorëve ekonomik me oferta më të ulëta të paraqesin analiza çmimesh bazuar dokumenteve të tenderit. Operatori me ofertë më të ulët në analizat e dhëna prej tij, ndryshon çmimet nga oferta fillestare, ku janë paraqitur më të larta dhe nga ana e Autoritetit Kontraktor është gjykuar si shkak për s'kualifikim. Me rritjet e çmimeve nga operatori ekonomik, përsëri oferta e këtij operatori të papërgjegjshëm ngelet më e ulët.

-Nga Autoriteti Kontraktor nuk është marrë asnjë masë për verifikime të mëtejshme apo konfiskimin e sigurimit të ofertës në vlerë prej 10,800,000 lekë si operator i papërgjegjshëm, për të mbrojtur institucionin nga ofertuesit që tërhiqen para përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës së tyre, ose për refuzimin e nënshkrimit të kontratës. Për këto mosveprime, FSHZH-së i është shkaktuar një humbje prej 35,372,546 lekë nga diferenca e ofertës më të ulët me ofertën pasardhëse.

- Në këtë procedurë prokurimi nuk janë përdorur me eficensë, efektivitet dhe ekonomikitet fondet të cilat akordohen nga bankat donatore të huaja dhe që disbursohen nga Qeveria Shqiptare dhe nuk janë parandaluar risqet që paraqiten nga veprimet evazive të kompanive që ndërmarrin iniciativa për implentimin e punëve civile. Nuk është kryer një analizë mbi ofertat ekonomike dhe nuk është marrë asnjë masë për të paralajmëruar operatorin ekonomik, ku do i mbahej

sigurimin e ofertës dhe të detyronte operatorin t'i përgjigjej ofertës deri në fund të procedurës në përputhje me Dokumentet e Tenderit për të mbrojtur investitorin.

**Për këtë rekomandojmë:**

*Nga FSHZH të merren masa që në të ardhmen për zbatimin e procedurave të prokurimit, të përdoret menaxhimi i fondeve me efektivitet, me efikasitet dhe ekonomikitet, të akorduara nga bankat donatore , duke parandaluar risqet që paraqiten nga veprimet evazive të kompanive që ndërmarrin iniciativa për implementimin e punëve civile në projekte me financime të huaja në Shqipëri.*

***Menjëherë dhe në vazhdim***

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të procedurave të tenderit “**Rikonstruksioni i rrugës Tamarë-Vermosh Loti II** ” u konstatua se nuk pasqyrohet vlera e përlllogaritur e kontratës në dosjen e prokurimit, si dhe mënyra si është përcaktuar si dhe nuk është respektuar periudha e njoftimit për gabime, të meta dhe defekte sipas kontratës, 30 ditë pas fillimit të punimeve.

**Për këtë rekomandojmë:**

*FSHZH të merrë masa për të plotësuar dosjen e prokurimit me dokumentacionin e munguar për vlerën e përlllogaritur të kontratës.*

*-Të merren masa në të ardhmen, në të gjitha kontratat e punimeve të respektohet periudha e njoftimit për defekte, të meta, gabime dhe mbas kësaj periudhe mos të merren parasysh kërkesat për ndryshime të operatorëve ekonomik përveç rasteve të emergjencave.*

***Menjëherë dhe në vazhdim***

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile në tenderin “**Rikonstruksion i rrugës Iballë, Loti II** ” u konstatuan se nuk ka përshkrim për kushtet gjeologjike të zonës, problemet teknike dhe propozimet për sigurinë e qëndrueshmërisë së skarpatës, si dhe u konstatua një shkarje e një masivi shkëmbor i cili ka dëmtuar një gjatësi muri prej 12.2 ml, në disa seksione të shkarjeve rrjeta mbrojtëse është e dëmtuar dhe disa hyrje të tombinove janë të mbushura me material të skarpatave.

**Për këtë rekomandojmë:**

*FSHZH të marrë masa për realizimin e studimeve gjeologjike dhe përcaktimin e planeve të rrëshqitjes, për përcaktimin e nevojave për investime për parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme të mureve mbrojtës dhe riparimin e dëmtimeve të ndodhura nga rrëshqitjet e shkëmbit, zëvendësimin e rrjetave mbrojtëse të dëmtuar në segmentet problematikë në rrugën Iballë loti II, si dhe t'i kërkohet kontraktorit të kryhen riparimet e dëmtimeve të tombinove dhe të bëhet pastrimi i tyre nga materiali shkëmbor.*

***Menjëherë dhe në vazhdim***

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile në tenderin “**Rikonstruksion i segmentit Kukës-Shishtavec, loti II**” u konstatuan se në punimet e skarpateve, nuk ka përshkrim për kushtet gjeologjike të zonës për sigurinë e qëndrueshmërisë së skarpatës. Gjithashtu për shkak të shkarjeve (rrëshqitjeve) të shkëmbinjve e dherave në skarpatat anës rrugës, u dalluan disa prishje të shtresave asfaltike. Konkretisht në pikën 9+100 u konstatua rrëshqitje e skarpatës e cila rrezikon këtë segment rrugor.

**Për këtë rekomandojmë:**

*FSHZH të marrë masa për realizimin e studimeve gjeologjike dhe përcaktimin e planeve të rrëshqitjes, për llogaritjen e qëndrueshmërisë së skarpatës, duke kryer llogaritje inxhinierike bazuar studimeve gjeologjike, hidrologjike të pjesëve më të disfavorshme të rrugës dhe t’i kërkojë kontraktorit riparimin e rrugës për shkak të rrëshqitjeve si dhe riparimin e prishjeve të shtresave asfaltike.*

***Menjëherë dhe në vazhdim***

**12. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt “**Rikonstruksioni i rrugës Tamarë-Vermosh loti I**” u konstatuan se: Zbatimi i punimeve është ende në proces dhe janë realizuar 3 situacione pjesore (3 IPC). Zbatuesi i punimeve ..... ka njoftuar supervisorin e punimeve dhe FSHZH, ku i shprehet për shqetësimin e sigurisë së rrugës, për rrëshqitjet e skarpateve anës rrugës. Mbi këtë shqetësim operatori ekonomik ka bashkëngjitur raport gjeologjik mbi terrenin nga kompania gjeoteknike ....., i cili përshkruan kushtet gjeologjike, gjeomorfologjinë e zonës, gjeologjinë e përgjithshme të zonës, problemet teknike dhe propozimet për sigurinë e qëndrueshmërisë së skarpatës.

*Nga verifikimet e librezës së masave për 3 IPC-të e punimeve, konstatohet se janë ndarë me përqindje (%) të ndryshme formacionet gjeologjike për çdo seksion të rrugës, pa u kryer një analizë apo studim gjeologjik, gjeoteknik i cili të shërbejë për llogaritjen e pagesave në gjermime. Nga mungesa e një raporti gjeologjik për verifikimet përkatëse, grupi i auditimit gjendet në pamundësi për të gjykuar objektivisht, lidhur me likuidimet e zërave në gjermim për materialet e papërshtatshme, gjermim në shkëmb të butë dhe në shkëmb të fortë.*

*Në asnjë rresht të këtij raporti nuk janë paraqitur ndarjet e formacioneve gjeologjike të seksioneve të rrugës dhe nga ana e supervisorit (konsulencës), investitorit nuk është marrë asnjë masë për realizimin e propozimeve të mësipërme.*

**Për këtë rekomandojmë:**

*FSHZH për rastin konkret dhe në vazhdimësi të zbatimit të projekteve, t’i kërkojë kontraktorit dhe supervisorit të rakordojnë volumet e përqindjeve të gjermimeve duke u mbështetur në raporte gjeologjike të mirëfilltra zyrtare të pavarura.*

***Menjëherë dhe në vazhdim***



**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Qeparo-Kudhës-Kuç” Vlorë, deri në momentin e auditimit për 3 situacione pjesore, u konstatua se është shtyrë afati i përfundimit të punimeve duke mos dhënë asnjë justifikim apo relacion argumentues nga kontraktori, supervizori dhe menaxheri i kontratës për vonesa në realizim e objektit. Në administrimin e pjesëshëm të dokumentacionit të punimeve mungojnë korrespondencat e palëve për miratimin, konsultimin e urdhërit të ndryshimit për zgjatjen e përfundimit të punimeve.

**Për këtë rekomandojmë:**

*FSHZH për rastin konkret për 3 situacionet pjesore dhe deri në përfundim të punimeve, t’i përmbahet me korrektësi kërkesave të kontratës FIDIC në miratimin e Urdhërave të ndryshimit për shtyrjen e afatit të punimeve, mbështetur në argumenta dhe relacione bindëse.*

*Menjëherë dhe në vazhdim*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me **vlërën 10,458,560 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Për tenderin “Rikonstruksion i aksi (A) -0.208 km, Aksi (B) – 0.274 km (Lagjes Gurra), Blloku pas Katëdrales (km 0-166.2 dhe 36.7 deri 131.3) deri 0.261, Blloku 11.2 ha (km 0-92.21 dhe 60.42 ml) deri 0.152 km; Rruga Spital-Gurra- 0.460 km”, janë paraqitur në tender dy operatorë ekonomik. Operatori me ofertën më të leverdishme “.....” Sh.p.k nuk ka paraqitur deklaram bankar për gjendjen financiare “Cash floë”, por vetëm një vetëdeklarim. FSHZH me E-mail të datës 23.03.2015, i ka kërkuar këtij operatori që brenda datës 25.03.2015 të paraqesë deklaramin bankar për gjendjen me vlerë, të paktën 32,884,800 lekë. Ky opertor është përgjigjur me E-mail të datës 26.03.2015, në të cilin përshkruhet: “*Dëshirojmë të ju informojmë se në lidhje me kërkesën tuaj të datës 23.03.2015, “.....” sh.p.k nuk ka dokument të cilin mund ta paraqesë sipas formës nr. 3, për këtë kontratë*”. Mos paraqitja e këtij dokumenti ka rezultuar me kualifikimin e operatorit të dytë me ofertë financiare me vlerë më të madhe në shumën 14,395,450 lekë.

Për këtë arsye KVO, ka propozuar s’kualifikimin nga gara të këtij OE. Operatori ekonomik ka paraqitur një xhiro vjetore të konsiderueshme gjatë 5 viteve të fundit me një mesatare 636,450,681 lekë. Po ashtu, ky OE ka marrë pjesë edhe në tenderë të tjerë ku ka paraqitur gjendjen financiare me vlera të konsiderueshme.

Mos dhënia përgjigje e operatorit ekonomik “.....” sh.p.k për paraqitjen e dokumenteve të tenderit sipas kërkesës duhet të konsiderohej si refuzim dhe bazuar

në Pikën 2.16 të Udhëzuesit të Prokurimit të IDB “Sigurimi i ofertës” përcaktohet: “Përfituesi duhet të kërkojë nga ofertuesit një sigurim oferte për të siguruar vlefshmërinë e ofertës me periudhën sipas dokumenteve të tenderit...”. Është vepruar në kundërshtim me Seksionin 1, Pika 19. 6. a, të dokumenteve të tenderit ku përcaktohet: “Sigurimi i ofertës mund të konfiskohet në qoftë se një ofertues tërhiqet përgjatë periudhës së vlefshmërisë së saj”, duke qenë se operatori ekonomik ka refuzuar paraqitjen e dokumentacionit të deklaruar nga vetë ai, nga KVO duhet të bëhej njoftimi përkatës për konfiskimin e garancisë së ofertës. **Mos realizimi i këtij detyrimi ka shkaktuar një dëm ekonomik me vlerë 1,319,390 lekë, vlerë e cila përbën sigurimin e ofertës.**

### **Për këtë rekomandojmë:**

FSHZH të marrin masa për arkëtimin e vlerës **1,319,390 lekë**, nga shoqëria “.....” sh.p.k, si dëm ekonomik i ardhur nga mosmbajtja e sigurimit të ofertës në tenderin me objekt “Rikonstruksion i aksi (A) -0.208 km, Aksi (B) – 0.274 km (Lagjes Gurra), Blloku pas Katëdrales (km 0-166.2 dhe 36.7 deri 131.3) deri 0.261, Blloku 11.2 ha (km 0-92.21 dhe 60.42 ml) deri 0.152 km; Rruga Spital-Gurra- 0.460 km”.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit dhe të punimeve civile në tenderin me objekt “**Rikonstruksion i segmentit 1 Maj – Unaza, Himarë**” u konstatuan se:

**a-** Operatori ekonomik “.....” SHPK, me drejtues ligjor z. ...., është financuar për zëra punimesh të pakryera të maskuara (Gërmime rruge, kanale dhe shtresat si dhe material i gërmuar më parë, për mbushje të rrugës) **dhe të pa argumentuara me dokumentacion teknik për shkak të ndryshimit të kuotave të tokës dhe projektit, në shumën 2,671,892 lekë me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.** Zbatuesi i punimeve për shkak të deklarimit të gërmimeve dhe mbushjeve të pajustificuara, ka përfutur 3,827.76 m<sup>3</sup> gërmime në kanale, rrugë, nënshtresat dhe 772.75 m<sup>3</sup> mbushje.

**b-** Nga verifikimi i dosjes së prokurimit u konstatua se të dhënat në planin e prokurimit në dosje ndryshojnë nga plani i prokurimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit sepse gjatësia e rrugës tek plani i prokurimit në dosje është 3,9 km.

Bazuar raportit të vlerësimit të tenderit më datë 19.11.2014 është s'kualifikuar oferta më çmim më të ulët e operatorit ekonomik “.....” sh.p.k me vlerë 162,478,440 lekë për shkak të keqlllogaritjes në ofertë dhe është shpallur fitues oferta e dytë e operatorit ekonomik “.....” sh.p.k me çmim 214,258,680 me TVSH. Ndërkohë në korespondencat midis palëve, operatori “.....” sh.p.k nuk merr përsipër realizimin e punimeve dhe nga ana e FSHZH këtij operatori, **nuk i është mbajtur sigurimi i ofertës me vlerë prej 3,249,570 lekë në përputhje me seksioni 1, pika 19.6(a) të dokumenteve të tenderit e cila përbën dëm ekonomik.**

**Për këtë rekomandojmë:**

1. FSHZH, të marrë masa që të pasqyrohet në certifikatën përfundimtare (Finale IPC) të pagesës si zbritje, vlera **2,671,892 lekë**, përfituar padrejtësisht nga shoqëria zbatuese e punimeve "....." sh.p.k, për diferenca në volume pune të pakryera në objektin "Rikonstruksion i segmentit I Maj – Unaza, Himarë".
2. FSHZH të marrin masa për arkëtimin e vlerës **3,249,570 lekë**, nga operatori ".....", si dëm ekonomik i ardhur nga mosmbajtja e sigurimit të ofertës në tenderin me objekt "Rikonstruksioni i segmentit I Maj-Unaza, Himare".

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile në tenderin me objekt "Rikonstruksion i rrugës Iballë, loti II" u konstatuan se është financuar operatori ekonomik "....." SHPK me drejtues ligjor ....., për zëra punimesh të pakryera, në shumën **120,552 lekë** me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. Zbatuesi i punimeve për shkak të mos rakordimit të volumeve të gërmimeve pa u mbështetur në raporte gjeologjike ka diferenca gërmimesh.

**Për këtë rekomandojmë:**

FSHZH, të marrë masa që të pasqyrohet në certifikatën përfundimtare (Finale IPC) të pagesës si zbritje, vlera **120,552 lekë**, përfituar padrejtësisht nga operatori "....." sh.p.k, për diferenca në volume pune të pakryera në objektin "Rikonstruksion i rrugës Iballë, loti II".

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile në tenderin me objekt "Rikonstruksion i segmentit Kukës-Shishtavec, loti II" u konstatuan se është financuar shoqëria ".....shpk" përfaqësuar nga z. ....., për zëra punimesh të pakryera, në shumën **436,406 lekë** me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. Zbatuesi i punimeve për shkak të mos rakordimit të volumeve të gërmimeve ka pasqyruar volume gërmimesh pa u mbështetur në raporte gjeologjike.

**Për këtë rekomandojmë:**

FSHZH, të marrë masa që të pasqyrohet në certifikatën përfundimtare (Finale IPC) të pagesës si zbritje, vlera **436,406 lekë**, përfituar padrejtësisht nga shoqëria ".....shpk", për diferenca në volume pune të pakryera në objektin "Rikonstruksion i rrugës Kukës-Shishtavec".

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile në tenderin me "Rikonstruksion i rrugës Qesarakë" Komuna Dajt, Tiranë u konstatuan se është financuar shoqëria "....." sh.p.k përfaqësuar nga z. ....., për zëra punimesh të pakryera, në shumën **1,140,090 lekë** me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

**Për këtë rekomandojmë:**

*FSHZH, të marrë masa që të pasqyrohet në çertifikatën përfundimtare (Finale IPC) të pagesës si zbritje, vlera 1,140,090 lekë , përfituar padrejtësisht nga shoqëria "....." sh.p.k, për diferenca në volume pune të pakryera në objektin “Rikonstruksion i rrugës Qesarakë ”.*

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile në tenderin me “**Restaurimi i urës së Velabishtit**” u konstatuan se është financuar shoqëria "..... shpk" përfaqësuar nga z. ...., për zëra punimesh të pakryera, në shumën **84,120 lekë** me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

**Për këtë rekomandojmë:**

*FSHZH, të marrë masa që të pasqyrohet në çertifikatën përfundimtare (Finale IPC) të pagesës si zbritje, vlera 84,120 lekë , përfituar padrejtësisht nga shoqëria ".....shpk", për diferenca në volume pune të pakryera në objektin “Restaurimi i urës së Velabishtit”.*

**Menjëherë**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile në tenderin me “**Rikonstruksion i rrugës në lagjen Gurra, blloku pas Katedrales, blloku 11.2 ha dhe rruga Gurra spital, loti i parë**” Lezhë, u konstatuan se është financuar Bashkimit të Operatorëve Ekonomik JV “.....” sh.p.k & “.....” sh.p.k përfaqësuar nga z. ...., për zëra punimesh të pakryera, në shumën **257,430 lekë** me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

**Për këtë rekomandojmë:**

*FSHZH, të marrë masa që të pasqyrohet në çertifikatën përfundimtare (Finale IPC) të pagesës si zbritje, vlera 257,430 lekë , përfituar padrejtësisht nga operatori Bashkimit të Operatorëve Ekonomik JV “.....” sh.p.k, për diferenca në volume pune të pakryera në objektin “Rikonstruksion i rrugës në lagjen Gurra, blloku pas Katedrales, blloku 11.2 ha dhe rruga Gurra spital, loti i parë” Lezhë.*

**Menjëherë**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile në tenderin me “**Rikonstruksion i rrugës Begjunec dhe rrugës segmentit Vakuf- shkolla 9-vjeçare Vakuf**” Dibër, u konstatuan se është financuar Bashkimit të Operatori Ekonomik “.....” sh.a, përfaqësuar nga z. ...., për zëra punimesh të pakryera, në shumën **1,182,110 lekë** me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

**Për këtë rekomandojmë:**

*FSHZH, të marrë masa që të pasqyrohet në çertifikatën përfundimtare (Finale IPC) të pagesës si zbritje, vlera 1,182,110 lekë, përfituar padrejtësisht nga*

Operatori Ekonomik “.....” sh.a, përfaqësuar nga z. ...., për diferenca në volume pune të pakryera në objektin “Rikonstruksion i rrugës Begjunec dhe rrugës segmentit Vakuf- shkolla 9-vjeçare Vakuf” Dibër.

*Menjëherë*

### **C. MASA PËR PËRDORIMIN ME EFEKTIVITETE TË FONDEVE**

Nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit të merren masa, me qëllim për përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve në vlerën **145,800 Euro (ose 20,266,200 Lekë)**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në Tenderin me objekt “Supervizioni i punimeve civile përfshirë monitorimin, inspektimin dhe raportimin e aktiviteteve të supervizionit, në kuadër të projektit të rrugëve dytësore dhe lokale” u konstatua se:

Operatori fitues, JV .....sh.p.k me te cilin janë lidhur dy kontrata sipas donatoreve: Vlera e kontratës së supervizorit pa TVSH financuar nga EBRD (BERZH), datë 28.01.2013 është 2,788,922.10 Euro dhe Vlera e kontratës është 714,272.90 Euro pa TVSH financuar nga KfW, datë 10.04.2013.

-Në Dokumentet Standarde të Tenderit të procedurës së prokurimit të supervizorit të punimeve u konstatua se :

Në termat e referencës, pika F, seksioni 26 ( Masat Institucionale) së parashikuara në DST për supervizorin e projektit, ofertuesit duhet të parashikonin një shumë të rimbursueshme kostoje për blerjen e 18 automjeteve prej 15,000 Euro (për njësi) plus TVSH dhe ndarja proporcionale e makinave të reja midis donatorëve financues do të ishte: BERZH financon blerjen e 11 automjeteve dhe KfW blerjen e 7 automjeteve, dhe të gjitha automjetet do t’i dorëzohen FSHZH-së në mbarim të kontratës. Në këto terma *nuk janë përcaktuar specifikimet teknike për këto automjete, dhe ngarkonet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit të Projektit.*

- Miratimi i adendumit i datës 27 Maj 2013 të kontratës së supervizorit ..... për blerjen e 7 automjeteve shtesë , është bërë pa marrë në konsideratë se 7 automjete do të merreshin në dorëzim nga ..... nga Supervizori i mëparshëm, bazuar në termat e referencës, pika F, seksioni 28 ( Masat Institucionale) të parashikuara në dokumentet standarde të tenderit. **Blerja e shtatë automjeteve, ndërkohë që 7 automjete jane dorëzuar nga supervizori i mëparshëm është shpenzim i panevojshëm, ka rritur koston e projektit dhe kjo ka sjellë përdorim pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike ne vlerën 105,000 Euro**

Për Kontratën e Supervizorit me donator KfW e lidhur më datë 10.04.2013, është bërë Adendumi nr.1 nga FSHZH dhe nga KfW përgatitur dhe miratuar në datën 2.12.2014, miratimi i procedurës për shërbimin e auditimit të sigurisë rrugore me vlerë 40,800 Euro, ky miratim është në kundërshtim me ligjin nr. 10408, datë 31.3.2011 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit dhe programit ndërmjet

Republikës së Shqipërisë, pasi ne marrëveshje nuk përcaktohet se kredia e përfshin shërbimin e auditimit të sigurisë rrugore, **duke rritur koston e projektit në vlerën 40,800 Euro, dhe përdorimin pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike pa përcaktuar shkaqet dhe arsyet reale të nevojës së kryerjes së tij.**

- Nga shqyrtimi i dosjes së prokurimit rezulton se, nuk ka një përlllogaritje të kostos paraprake të këtij shërbimi, për më tepër nuk justifikohet fakti që ky auditim të realizohet nga vete supervizori i punimeve [REDACTED]

Per periudhen e audituar nga lidhja e kësaj kontrate kane përfunduar dy segmente rrugore perkatesisht: Kontrata WL-Rec 82 Rruga Kombëtare - Qelëz me gjatësi 12.84 km me datë fillimi punimesh në 01.05.2013 dhe datë përfundimi në 14.10.2015, dhe WL-Rec 83-1 Rruga Kombëtare –Iballë, Loti 2 me gjatësi 13.71 km, me datë fillimi punimesh 15.05.2014 dhe datë përfundimi në 15.01.2016. Nga eksperti i sigurisë rrugore, është audituar vetëm segmenti i pare, në datën 9.11.2015 për te cilin është sjelle vetëm draft raporti dhe mungon raporti përfundimtar dhe miratimi nga KfW ndërsa për segmentin e dyte nuk ka filluar akoma procesi auditues megjithëse ky segment ka përfunduar me 15.01.2016. Kanë kaluar 4 muaj nga përfundimi i punimeve si rrjedhojë për mospërmbushjen në kohë të këtij shërbimi ngarkohet me përgjegjësi Supervizori i punimeve [REDACTED] dhe [REDACTED], Ekspert i Auditimit të Sigurisë Rrugore.

***Për këtë rekomandojmë:***

*FSHZH të merrë masa, që në të ardhmen të respektohen termat e marrëveshjeve të financimit të projekteve, sipas kushteve të përcaktuara për procedurat e prokurimit të mbikqyrjes së punimeve, duke parashikuar fondet e implementimit me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet.*

***Menjëherë***

**D. MASA DISIPLINORE.**

Mbështetur në nenin nr. 37, të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe kontratës individuale neni 9, kërkojmë nga Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri “Largim nga puna”, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për:

**1. Z. [REDACTED],** me detyrë Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për arsye se:

- Për mos mbajtjen e sigurimit të ofertës në vlerën 1,319,390 lekë, nga subjekti “[REDACTED]” sh.p.k në tenderin me objekt “Rikonstruksion i aksit (A) - 0.208 km, Aksi (B) – 0.274 km (Lagjes Gurra), Blloku pas Katedrales (km 0-166.2 dhe 36.7 deri 131.3) deri 0.261, Blloku 11.2 ha (km 0-92.21 dhe 60.42 ml) deri 0.152 km; Rruga Spital-Gurra- 0.460 km”, i zhvilluar në vitin 2011, duke qenë se operatori ekonomik ka refuzuar paraqitjen e dokumentacionit të deklaruar nga vetë ai.

- Për mos trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, në tenderin me objekt “Rikonstruksion i rrugës Qeparo-Kudhës-Kuç, segmenti Qafe Shper-Kudhës, Qarku i Vlorës” pasi një mangësi e një operatori nuk është konsideruar mangësi për operatorin fitues.

- Për mos mbajtjen e sigurimit të ofertës në vlerën 3,249,570 lekë, nga subjekti “.....” sh.p.k në tenderin me objekt “Rikonstruksion i segmentit 1 Maj-Unaza” i zhvilluar në vitin 2014, sepse operatori “.....” sh.p.k nuk ka marrë përsipër realizimin e punimeve dhe nga FSHZH nuk i është mbajtur sigurimi i ofertës.

**2. Z. ....**, me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për arsye se:

- Për mos mbajtjen e sigurimit të ofertës në vlerën 1,319,390 lekë, nga subjekti “.....” sh.p.k në tenderin me objekt “Rikonstruksion i aksit (A) - 0.208 km, Aksi (B) – 0.274 km (Lagjes Gurra), Blloku pas Katedrales (km 0-166.2 dhe 36.7 deri 131.3) deri 0.261, Blloku 11.2 ha (km 0-92.21 dhe 60.42 ml) deri 0.152 km; Rruga Spital-Gurra- 0.460 km”, i zhvilluar në vitin 2011, duke qenë se operatori ekonomik ka refuzuar paraqitjen e dokumentacionit të deklaruar nga vetë ai.

- Për mos trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, në tenderin me objekt “Rikonstruksion i rrugës Qeparo-Kudhës-Kuç, segmenti Qafe Shper-Kudhës, Qarku i Vlorës” pasi një mangësi e një operatori nuk është konsideruar mangësi për operatorin fitues.

- Për mos mbajtjen e sigurimit të ofertës në vlerën 3,249,570 lekë, nga subjekti “.....” sh.p.k në tenderin me objekt “Rikonstruksion i segmentit 1 Maj-Unaza” i zhvilluar në vitin 2014, sepse operatori “.....” sh.p.k nuk ka marrë përsipër realizimin e punimeve dhe nga FSHZH nuk i është mbajtur sigurimi i ofertës.

**3. Z. ....**, me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për arsye se:

- Për mos mbajtjen e sigurimit të ofertës në vlerën 1,319,390 lekë, nga subjekti “.....” sh.p.k në tenderin me objekt “Rikonstruksion i aksit (A) - 0.208 km, Aksi (B) – 0.274 km (Lagjes Gurra), Blloku pas Katedrales (km 0-166.2 dhe 36.7 deri 131.3) deri 0.261, Blloku 11.2 ha (km 0-92.21 dhe 60.42 ml) deri 0.152 km; Rruga Spital-Gurra- 0.460 km”, i zhvilluar në vitin 2011, duke qenë se operatori ekonomik ka refuzuar paraqitjen e dokumentacionit të deklaruar nga vetë ai.

- Për mos trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, në tenderin me objekt “Rikonstruksion i rrugës Qeparo-Kudhës-Kuç, segmenti Qafe Shper-Kudhës, Qarku i Vlorës” pasi një mangësi e një operatori nuk është konsideruar mangësi për operatorin fitues.

- Për mos mbajtjen e sigurimit të ofertës në vlerën 3,249,570 lekë, nga subjekti “.....” sh.p.k në tenderin me objekt “Rikonstruksion i segmentit 1 Maj-Unaza” i zhvilluar në vitin 2014, sepse operatori “.....” sh.p.k nuk ka marrë përsipër realizimin e punimeve dhe nga FSHZH nuk i është mbajtur sigurimi i ofertës.

**4. Z. ....**, me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për arsye se:

- Për mos mbajtjen e sigurimit të ofertës në vlerën 1,319,390 lekë, nga subjekti “.....” sh.p.k në tenderin me objekt “Rikonstruksion i aksit (A) - 0.208 km, Aksi (B) – 0.274 km (Lagjes Gurra), Blloku pas Katedrales (km 0-166.2 dhe 36.7 deri 131.3) deri 0.261, Blloku 11.2 ha (km 0-92.21 dhe 60.42 ml) deri 0.152 km; Rruga Spital-Gurra- 0.460 km”, i zhvilluar në vitin 2011, duke qenë se operatori ekonomik ka refuzuar paraqitjen e dokumentacionit të deklaruar nga vetë ai.

- Për mos trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, në tenderin me objekt “Rikonstruksion i rrugës Qeparo-Kudhës-Kuç, segmenti Qafe Shper-Kudhës, Qarku i Vlorës” pasi një mangësi e një operatori nuk është konsideruar mangësi për operatorin fitues.

- Për mos mbajtjen e sigurimit të ofertës në vlerën 3,249,570 lekë, nga subjekti “.....” sh.p.k në tenderin me objekt “Rikonstruksion i segmentit 1 Maj-Unaza” i zhvilluar në vitin 2014, sepse operatori “.....” sh.p.k nuk ka marrë përsipër realizimin e punimeve dhe nga FSHZH nuk i është mbajtur siguri i ofertës.

**5. Z. ....**, me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për arsye se:

- Për mos mbajtjen e sigurimit të ofertës në vlerën 1,319,390 lekë, nga subjekti “.....” sh.p.k në tenderin me objekt “Rikonstruksion i aksit (A) - 0.208 km, Aksi (B) – 0.274 km (Lagjes Gurra), Blloku pas Katedrales (km 0-166.2 dhe 36.7 deri 131.3) deri 0.261, Blloku 11.2 ha (km 0-92.21 dhe 60.42 ml) deri 0.152 km; Rruga Spital-Gurra- 0.460 km”, i zhvilluar në vitin 2011, duke qenë se operatori ekonomik ka refuzuar paraqitjen e dokumentacionit të deklaruar nga vetë ai.

- Për mos trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, në tenderin me objekt “Rikonstruksion i rrugës Qeparo-Kudhës-Kuç, segmenti Qafe Shper-Kudhës, Qarku i Vlorës” pasi një mangësi e një operatori nuk është konsideruar mangësi për operatorin fitues.

**6. Znj. ....**, me detyrë përgjegjëse e njësisë së prokurimit për arsye se:

- Për vendosje kritere diskriminimi, në tenderin me objekt “Rikonstruksion i rrugës Qeparo-Kudhës-Kuç, segmenti Qafe Shper-Kudhës, Qarku i Vlorës” pasi është eliminuar nga gara një operator ekonomik si dhe është limituar mundësia për pjesëmarrje të operatorëve të tjerë.

- Për vendosje e një vlere të ulët të sigurimit të ofertës ka bërë që operatori ekonomik të tërhiqet më lehtësisht nga gara, në tenderin me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Shishtavec Loti 3” veprim i cili ka shkaktuar realizim të punimeve me vlerë më të lartë në shumën 52,133,620 lekë.

- Për rritje kosto të projektit në vlerën 105,000 Euro, për blerjen e automjeteve dhe 40,800 Euro për shërbimin e auditimit të sigurisë rrugore, pa përcaktuar shkaqet dhe arsyet reale për tenderin me objekt “Supervizioni i punimeve civile përfshirë monitorimin, inspektimin dhe raportimin e aktiviteteve të supervizionit, në kuadër



të projektit të rrugëve dytësore dhe lokale” duke sjellë si pasojë përdorimin pa efektivitet, pa ekonomikitet dhe pa efikasitet të fondeve publike.

**7. Z. ....**, me detyrë specialistë i njësisë së prokurimit për arsye se:

- Për vendosje kritere diskriminimi, në tenderin me objekt “Rikonstruksion i rrugës Qeparo-Kudhës-Kuç, segmenti Qafe Shper-Kudhës, Qarku i Vlorës” pasi është eliminuar nga gara një operator ekonomik si dhe është limituar mundësia për pjesëmarrje të operatorëve të tjerë.

- Për vendosje e një vlere të ulët të sigurimit të ofertës ka bërë që operatori ekonomik të tërhiqet më lehtësisht nga gara, në tenderin me objekt “*Rikonstruksion i Rrugës Shishtavec Loti 3*” veprim i cili ka shkaktuar realizim të punimeve me vlerë më të lartë në shumën 52,133,620 lekë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**